



Pranuar / Dorezuar Punimje/Prodato Received/Delivery	28.12.2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHAKA	8497/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1026/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1026 /2022 të datës 18.11.2022 të parashtruar nga ankuesja [] me adresë [] në Komunën e Vushtrrisë, kundër Vendimit me numër Nr.1431/2022 të datës 10.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil-Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1206/2022 e datës 18.11.2022 e parashtruar nga ankuesja []

A r s y e t i m

Ankuesja [] është e punësuar fillimisht në Ministrinë e Punëve të Brendshme, sipas Akt emërimit me numër Nr.Ref: ARC-3/13 të datës 31.01.2013 në pozitën "Inspektore" tek Agjencia e Regjistrimit Civil-Departamenti: Inspektorati i Agjencisë së Regjistrimit Civil, ndërsa sipas ndryshimit të Akt emërimit të datës 30.11.2015 e njëjta mban pozitën si "Zyrtare e lartë për letërnjoftime"-Sektori për letërnjoftime në kuadër të Drejtoratit për Pajisje me Dokumente, ARC/MPB.

Me datën 10.01.2022 Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, ka nxjerrë Vendimin Nr.1431/2022, sipas së cilit nëpunësen [] Inspektore e ARC-së pranë Sektorit të Inspektoratit të ARC/MPB, e ka caktuar zëvendësuese e

Udhëheqësit të Sektorit të Dokumenteve të Udhëtimit-Drejtorati për Pajisje me Dokumente-ARC/MPB.

E pakënaqur me Vendimin Nr.1431/2022 të datës 10.11.2022, me datën 18.11.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 7213/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, Ligjit të ARC-së si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 29.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli me datën 08.12.2022, ka pranuar përgjigjen nga kjo e fundit në ankesë, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit: 7213/2022 të datës 18.11.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshimin e akt emërimit të ankueses të datës 30.11.2015; Akt emërimit të ankueses me numër Nr.Ref: DRGJC/ARC-6/13 të datës 31.01.2013; Vendimin me numër Nr.298 të datës 18.06.2018; Vendimin me numër Nr.46/2016 të datës 26.01.2016; Vendimin me numër Nr.13/2021 të datës 23.07.2021; Vendimin me numër Nr.1257/2013 të datës 26.12.2013; Vendimin me numër Nr.44/2016 të datës 14.09.2016; Vendimin me numër Nr.260/2012 të datës 17.04.2012; Kërkesën për Përgjigje në ankesë të datës 29.11.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 08.12.2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Përshkrimin e detyrave të punës së ankueses të datës 15.05.2015; Përshkrimin e detyrave të punës së ankueses të datës 27.04.2015; Vendimin me numër Nr.1431/2022 të datës 10.11.2022 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të ARC-së; Kërkesën përmes e-mailit zyrtar të datës 08.11.2022; Shkresën zyrtare përmes e-mailit të datës 18.11.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, është e palejuar, *sepse:*

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi, duke konstatuar se me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet se: *"Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji..."*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave sa i përket çështjes se kush konsiderohet palë në procedurën administrative, i 'u referua nenit 14 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative;*

1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenohet të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative". Ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtari i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë", kështu që, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se vendimi i kontestuar me ankesë nuk cenon ndonjë të drejtë apo interes juridik të ankueses, gjegjësisht ankuesja nuk ka legjitimitetin e palës për të parashtruar ankesë kundër Vendimit me numër Nr.1431/2022 të datës 10.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, andaj si rrjedhojë dhe bazuar në këtë konstatim si dhe duke iu referuar nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesa e ankueses konsiderohet se është pa pranueshme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1026/2022, datë 28.12.2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së